Dt. 16.07.2024
Nr. 1890 prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË

Nr.680 çeshtjes
Dt.28.5.2024 regj

Lezhë me date 7.6.2024

Lenda: Njoftim per leshimin e deklarates se mbrojtjes.

**Drejtuar:**

1. **Pjorin Gjelaj,** atësia Nosh, amësia Age, i dtl 22.6.1975, me adresë Lagjia "8 Nëntori", Nd.083, Shkodër, me nr identifikues H50622093U;
2. **Marjanë Curraj,** atësia Nosh, amësia Age, e dtl 15.7.1977 me adresë Lagjia "3 Heronjtë", Nd.12, Shkodër, me nr identifikues H75715099C;
3. **Miranda Curri,** atësia Nosh, amësia Age, e dtl 29.4.1980, me adresë Kastrat, Bajzë Qëndër, Lagjia "Aliaj", Nd.44, H.1, Malësi e Madhe, Shkodër, me nr identifikues I05429084K;
4. **Nosh Gjelaj,** atësia Kolë, amësia Rozë, i dtl 11.7.1944, me adresë Lagjia "8 Nëntori", Nd.0863, Shkodër, me nr identifikues E40711022Ë;

Bazuar ne nenet 133/a dhe 158 te Kodit te Proçedures Civile, njoftohet me shpallje publike shtetasit e mësipërm në adresat përkatese se ne Gjykaten Lezhe kunder tyre eshte parashtruar padia e paditësit Ilir Gjeka etj me objekt pjestim pasurie etj. Ne referim te pikes 1 te nenit 158 te Kodit te Proçedures Civile, i kërkohen palëve të paditura të mësipërme qe jo me vone se 30 dite nga afishimi i kesaj shpallje te leshojne deklaraten e mbrojtjes, e cila duhet te jete ne forme shkresore, e hartuar ne gjuhen Shqipe, ne dy kopje, dhe te permbaje:

1) gjykatën përpara së cilës paraqitet deklarata e mbrojtjes;
2) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditëses, të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka.
3) Nëse paditësi ose i padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;
4) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka.

Perveç te dhenave te mesiperme, duhet te deklaroni qarte ne/ose bashkengjitur deklarates se mbrojtjes te dhenat e meposhtme:

5) të dhënat e kontaktit elektronik ose të përfaqësuesve tuaj, nëse keni, të cilat gjykata mund t'i përdorë për njoftime;
6) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit, duke specifikuar saktë emrat e tyre, atësinë, mbiemrin, dhe adresën e tyre të plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;
7) provat që kërkohen të merren tek të tretët ose te paditësia, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave;
8) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;
9) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin e personit juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkoni të thirren në gjykim me këtë cilësi;
10) kundërpadinë, kur kërkohet, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

Perveç sa me siper, duhet të informoni gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik për vete ose përfaqësuesin tuaj. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.

Prapësimet dhe provat që mund të ngrihen ose paraqiten vetëm me kërkesë të palëve, nuk pranohen nga gjykata më pas, nëse nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes.

Ilir Perdeda

Gjyqtari i çeshtjes



Scanned with ACE Scanner